

PKR.nr.749/15

NË EMËR TË POPULLIT

REPUBLIKA E KOSOVËS - GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Naser Foniqi, me procesmbajtësen Sevdije Breznica, në çështjen penale të akuzuarit D.P., i akuzuar për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit tjetër të rrezikshëm, nga neni 375, par. 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës- në vijim KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr.342/2014, të datës 29.12.2015, në shqyrtimin fillestar, të hapur, të mbajtur më datë 28.08.2018, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i shtetit Besa Limani dhe i akuzuari D.P., ndërsa ka munguar i dëmtuari B.T., për të cilin në fletë dërgesë është shënuar “20.07.2018- sipas babait të tij, pala ka udhëtuar për në S.1”, pas seancës, me datë 28.08.2018, gjykata mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari D.P., i biri i S.2 dhe Q., e vajzërisë I., i lindur me datë ..., në fshatin H., Komuna O., me banim në P., lagjja “D.”, rr. “A.A.”, ..., kati ..., numër ..., me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i shkurorëzuar - pa fëmijë, i pa papunë - i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e: në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët, me datë 20.03.2014, rreth orës 03:40, në fshatin Ll., Komuna L., në restorantin “B.”, derisa ka qenë duke ndenjur dhe pirë me shokët e tij – persona të panjohur, tani i akuzuari D.P., kishte filluar të thyejë gota, dhe në momentin kur i dëmtuari B.T., kishte reaguar duke ia tërhequr vërejtjen, i akuzuari D., ka dal nga restoranti, ka shkuar në veturën e tij e pastaj është kthyer me një revole të tipit të panjohur të cilën e ka mbajtur në dorë, por me të vërejtur të dëmtuarin duke e thirrë policinë, i akuzuari dhe shokët e tij janë larguar nga lokali me veturën me targa ..., dhe janë nisur në drejtim të P., ndërsa më vonë në bagazhin e kësaj veture policia ka gjetur dhe sekuestruar një thikë 30 cm, e gjatë, e llojit “C Jul Herdertz Aisi 420, numër 119612 dhe një fatrollë,-

- me këtë, ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit tjetër të rrezikshëm, nga neni 375, par. 1, të KPRK.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: **41; 45; 48; 73, 75; 76, par. 1, nënpar. 1.5 dhe 375, par. 1 dhe 3, të KPRK**, si dhe nenit 365, të KPPK, të akuzuarit, i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

- në kohëzgjatje prej pesë (5) muaj
- Konform nenit 48, të KPRK, me pëlqimin e të akuzuarit D.P., dënimi me burgim i zëvendësohet në urdhër për punë në dobi të përgjithshme për periudhën prej njëqind e njëzet (120) orë pune, e cila duhet të kryhet brenda periudhës kohore prej gjashtë (6) muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- Shërbimi Sprovues i Kosovës, vendos për llojin e punës në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave duhet të kryhet puna dhe mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.
- Nëse i akuzuari nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht këtë punë, gjykata urdhëron dënimin me burgim.
- Obligohet i pandehuri të paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas listës së shpenzimeve, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **pesëdhjetë (50) €**, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- Të akuzuarit i konfiskohet arma- thika “C Jul Herdertz Aisi 420, numër 119612 dhe një fatrollë, e cila është si rezultat i kryerjes së veprës penale.
- **I dëmtuari B. (R.) T.**, nga fshati G. e U., Komuna L., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A R S Y E T I M I

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.I.nr.342/2014, të datës 29.12.2015, e ka akuzuar të pandehurin D.P., për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit tjetër të rrezikshëm, nga neni 375, par. 1, të KPRK.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari D.P., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe është deklaruar fajtorë për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe ka shtuar se i ka parasysh natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Po ashtu, i akuzuari ka thënë se këtë thikë policia e ka gjetur në bagazhin e veturës së tij 12 ditë pasi ka ndodhur ngjarja në restorantin B. në fshatin Ll., Komuna L., e të cilën thikë e kishte përdorur kur ka qenë në peshkim dy ditë më herët, por kishte harruar ta heq nga vetura. I akuzuari ka theksuar se nuk e ka ditur se mbajtja e thikës është vepër penale dhe ka kërkuar falje, duke e njoftuar gjykatën se ai jeton vetëm me babain e tij, i cili është pensionist dhe realizon një pension prej 160 euro në muaj, ndërsa vet i akuzuari punon herë pas here si shofer autobusi, ku ka të hyra përafërsisht 150-200 euro në muaj, duke kërkuar nga gjykata që ta ketë parasysh këtë gjendje.

Sa i përket pranimit të fajësisë nga i pandehuri, Prokurori i shtetit ka deklaruar, se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari D.P., për veprën penale si në hyrje të

procesverbalit të shqyrtimit fillestar, duke konsideruar se ky pranim i fajësisë është bërë në bazë të ligjit, duke qenë i njoftuar nga gjykata për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, dhe se ky pranim është bërë në përputhshmëri edhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Pas deklarimit të të akuzuarit se ndihet fajtorë për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi është bindur se ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht dhe duke u mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Po ashtu, edhe nga shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale **Përdorimi i armës apo mjetit tjetër të rrezikshëm, nga neni 375, par. 1, të KPRK**, si dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtorë të akuzuarin, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese siç janë: pranimi i fajësisë nga i pandehuri; sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit fillestar; si dhe gjendjen e tij ekonomike, ndërsa gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese, prandaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëj rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata ka zbutur dënimin ndaj të akuzuarit si më lart, duke pasur për bazë se i njëjti e ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer, ka qenë shumë i sinqertë ndaj gjykatës dhe se edhe me dënimin më të butë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Po ashtu, gjykata ka vlerësuar se ndaj të akuzuarit sipas KPRK mund të shqiptohet edhe dënim me gjobë, por gjendja ekonomike e të akuzuarit e ka bërë të pamundur shqiptimin e këtij lloji dënimi.

Pas shpalljes së aktgjykimit, i akuzuari është deklaruar se e pranon dënimin e shqiptuar dhe ka pranuar që ky dënim t'i zëvendësohet me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme.

Vendimi që të pandehurit t'i konfiskohet sendi i përdorur për kryerjen e veprës penale, u mor në bazë të nenit 375, par. 3, të KPRK.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë, në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPK, palët e dëmtuara janë udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 365, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 28.08.2018.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.749/15, datë 28.08.2018.

Procesmbajtëse,
Sevdije Breznica

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,
Naser Foniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë.